

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alinja 11 dhe neni 62 paragrafi 6 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), dhe neni 15, paragrafi 1, alineja 7 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-435/1 nga 29.08.2014, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5747/2 nga 21.11.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 19 të saj të mbajtur më 21.11.2014, e miratoi:

RREUGLLORE

PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE, HAPËSINORE, FINANCIARE DHE KADROVIKE PËR MARRJEN E LEJES PËR EMETIM RADIO DHE TELEVIZIV

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore i përcakton kushtet minimale teknike, hapësinore, kadroviqe dhe financiare, që duhet të plotësojnë radiodifuzerët që të emetojnë program në nivel lokal, rajonal dhe shtetëror.

Kjo rregullore nuk ka të bëjë me radiodifuzerët, në pjesën e dispozitave për posedimin e detyrueshëm të hapësirave të studios apo atyre shtesë, në rast kur shërbimi programor përmban vetëm emisione që në tërësi përgatiten ose janë hapësirave në vend tjetër (program i specializuar muzikor, filmik ose sportiv, program i teleshoppingut etj.)

Kjo rregullore në pjesën e hapësirave dhe parametrave themelor, nuk ka të bëjë me rastet kur emetimi, respektivisht incizimi, realizohet jashtë hapësirës së studios (stadium, manifestim kulturor ose sportiv, në hapësira të hapura, tubime të qytetarëve etj.)

II. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË RADIODIFUZERËT (RADIOT DHE TELEVISIONET)

Neni 2

Radiodifuzeri, për të bërë emetim të radios ose televiziv në rajonin për të cilin e ka marrë lejen për emetim radioteleviziv nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, për një nivel të caktuar të shikueshmërisë/respektivisht dëgjueshmërisë (nivel shtetëror, rajonal ose lokal), duhet të disponojë me pajisje dhe mjete teknike me të cilat sigurohet prodhimi dhe emetimi kualitativ i programit të tyre.

Pajisja duhet të jetë funksionale, e mirëmbajtur dhe servisuar, gjë për të cilën është përgjegjës vetë radiodifuzeri.

Në rast të ndërprerjeve të shpeshta ose problemeve më të mëdha teknike që ndikojnë në kualitetin e programit të prodhuar, radiodifuzeri duhet ta njoftojë Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Për emetimin e programit të vet, radiodifuzerët mund të përdorin radiofrekuenca, kapacitet të multipleksit digjital terestrial, satelit ose kapacitet nga operator të rrjetit të komunikimit publik elektronik që nuk përdorin resurse të kufizuara.

Secili radiodifuzer, për hapësirat ku e krijon ose emeton programin e vet dhe ku bën kontroll dhe incizim të sinjalit dalës (studio dhe regjia), patjetër duhet të ketë instaluar tokëzim mbrojtës.

Secili radiodifuzer në objektin e vet duhet të posedojnë energji të pandërprerë, me të cilën do të sigurojë pavarësi energjetike për funksionimin e funksioneve themelore të radiodifuzerit, respektivisht emetimit pa pengesa të programit. Varësisht nga niveli i shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (nivel shtetëror, rajonal ose lokal), radiodifuzerët duhet të plotësojnë këto kriteret në aspekt të energjisë së pandërprerë:

- për nivelin rajonal dhe lokal: pavarësi i plotë energjetike prej së paku 1 (një) ore;
- për nivelin shtetëror: pavarësi të plotë energjetike prej së paku 6 (gjashtë) orë;

III. V. KUSHTET PËR SHËRBIMET E PROGRAMEVE TË RADIOS (RADIOVE)

Kushtet, standardet dhe parametrat themelore teknike

Studio

Neni 3

Çdo radio që planifikon që në shërbimin e vet programor të prodhojë fjalë dhe/ose muzikë në emetim të drejtpërdrejtë ose të prolonguar në hapësirat e tyre, patjetër duhet të ketë hapësirë të studios së përpunuar akustike - studio

Parametrat e përbashkëta për studiot janë:

- Studio duhet të jetë e përpunuar në aspekt akustik dhe e izoluar nga zhurmat e jashtme;
- koha e reverberimit T_r :

$$0,25 \text{ s} < T_r < 0,4 \text{ s}$$

Ku T_r nuk guxon që të dal më shumë se $\pm 0,05$ s nga vlera nominale e përhapjes prej 200 Hz deri 4.000 Hz; dhe

- përdorimi i detyrueshëm i ventilimit dhe aklimatizimit (rekomandohet klimatizimi/ventilimi qendror).

Neni 4

Studio ose hapësira për incizim ose emetim të njoftimeve, lajmeve, deklaratave, komenteve, intervistave, bisedave, tribunave, tubimeve, leximeve të teksteve ose informatave të ngjashme nga bisedat, duhet të plotësojnë këto kriteret:

- sipërfaqja e hapësirës së përpunuar akustike nuk guxon që të jetë më e vogël se m^2
- nëse është e paraparë që në studio njëkohësisht të marrin pjesë më shumë se dy persona, sipërfaqja duhet të rritet për 2 m^2 për person;
- lartësia minimale e hapësirës së përpunuar akustike duhet të jetë 2,6 m.

Hapësira për regjinë

Neni 5

Hapësira për regjinë është hapësirë në të cilën, me ndihmën e pajisjeve elektronike

dhe elektroakustike udhëhiqet, përgatitet ose prodhohet programi me përmbajtje të bisedave ose muzikore dhe bëhet kontroll objektiv dhe subjektiv i zërit dhe sinjalit dalës.

Çdo radio duhet detyrimisht të posedojë hapësirë për regjinë.

Hapësira për regjinë duhet patjetër të plotësojë këto kritere:

- sipërfaqja e hapësirës pas përpunimit akustik të jetë 10 m^2 , me lartësi të hapësirës së përpunuar prej $2,6\text{m}$;
- forma e hapësirës duhet të jetë katror ose trapezoid. Për shkak të stereofonisë, nevojitet që të sigurohet simetri hapësirë dhe akustike, respektivisht boshti i simetrisë dhe boshti i dëgjimit të përputhen.
- hapësira për regjinë duhet të përpunohet për akustikë dhe të izohet nga zhurmat e jashtme.
- koha e reverberimit Tr :

$$0,25 \text{ s} < Tr < 0,4 \text{ s}$$

Ku Tr nuk guxon që të dal më shumë se $\pm 0,05 \text{ s}$ nga vlera nominale e përhapjes prej 200 Hz deri 4.000 Hz ; dhe

- në hapësirën për regjinë detyrimisht të përdoret ventilimi dhe aklimatizimi. nëse është e paraparë që në hapësirën për regjinë njëkohësisht të marrin pjesë më shumë se dy persona, sipërfaqja duhet të rritet për 2 m^2 për person;

Neni 6

Regjia mund që njëkohësisht të përdoret edhe si studio në rast kur shërbimi i programit të radios në emetimet e tyre përmban edhe pjesë me biseda.

Në rast kur tekniku/udhëheqësi, si dhe personat e tjerë që duhet të kenë kontroll mbi tonin (bashkëbiseduesit, mjeshtri i tonit etj.) në program, detyrimisht duhet të përdoren dëgjuese, karakteristika frekuentuese e të cilave duhet të jetë në pajtim me fotografinë 1.




Foto. 1 – Tolerimet e lejuara për karakteristikën amplitudë – frekuentuese të dëgjuesve të studiove për monitorim (sipas ITU rekomandimit – ITU-R BS. 708)

Në rast kur hapësira për regjinë përdoret edhe si studio, nevojitet që të plotësojë këto kritere:

- sipërfaqja e hapësirës pas përpunimit akustik të jetë 15 m^2 , me lartësi të hapësirës së përpunuar prej $2,6\text{m}$; dhe
- nëse është e paraparë që në hapësirën për studion/regjinë njëkohësisht të marrin pjesë më shumë se dy persona, sipërfaqja duhet të rritet për 2 m^2 për person;

Hapësirat plotësuese

Neni 7

Çdo radio për rajonin për të cilin ka marrë leje, respektivisht për një nivel të caktuar të

dëgjueshmërisë (nivel shtetëror, rajonal ose lokal), dhe cila planifikon që në shërbimin e saj programor, përveç përmbajtje të incizuara paraprake nga ndonjë lokacion tjetër, të emetojë edhe program personal drejtpërdrejtë ose në mënyrë të prolonguar (lajme, biseda me mysafir, kuize etj.) duhet patjetër të posedojë:

- Hapësira për gazetarë (redaksia) dhe për pjesëmarrës tjerë në program;
- Arkiv që shërben për ruajtjen e përmbajtjeve të audios që dalin nga obligimi për ruajtjen e incizimeve në kohëzgjatje prej së paku 60 ditë, arkivi mund të vendoset edhe në hapësira për qëllime tjera;
- Hapësira për vendosjen e pajisjes teknike-informatike, ku duhet të vendoset pajisja aktive, me ventilim adekuat dhe aklimatizim si dhe pajisje për energji të pandërprerë, dhe
- hapësira për tualete.

Kualiteti i sinjalit

Neni 8

Audio sinjali duhet patjetër të emetohet së paku në teknikë stereofonike, përveç kur bëhet fjalë për materiale historike, të incizuara në mënyrë monofonike.

Çdo radiodifuzer duhet të posedojë metodë për rregullimin e shumës dhe dinamika e tonit.

IV. KUSHTET KADROVIKE Numri i struktura e të punësuarve

Neni 9

Numri dhe struktura e personave të punësuar në radio në nivel shtetëror në format të përgjithshëm, duhet të jetë 10 (dhjetë), prej të cilëve 3 (tre) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Numri dhe struktura e personave të punësuar në radio në nivel shtetëror në format të specializuar, duhet të jetë 5 (pesë), prej të cilëve 2 (dy) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Numri dhe struktura e personave të punësuar në radio në nivel rajonal, duhet të jetë 5 (pesë), prej të cilëve 3 (tre) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Numri dhe struktura e personave të punësuar në radio në nivel lokal, duhet të jetë 3 (tre), prej të cilëve 2 (dy) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Si persona të punësuar, llogariten personat në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë të punës te radiodifuzeri dhe personat e angazhuar në bazë të kontratës në vepër dhe/ose kontratë autoriale.

V. VII KUSHTET PËR SHËRBIMIN PROGRAMOR TELEVIZIV (TELEVISIONI)

Kushtet themelore teknike dhe hapësinore, standardet dhe parametrat për pjesën e studios së televizioneve që emetojnë program në nivel lokal dhe rajonal

Studio

Neni 10

Çdo televizion, i cili planifikon që në shërbimin e vet programor të shfaq program të tyre

të prodhuar drejtpërdrejtë ose me prolongim (lajme, biseda me mysafir, kuize etj.) patjetër duhet të ketë hapsirë të përpunuar akustike të studios – studio televizive.

Varësisht nga dedikimi dhe numri i personave që planifikohen të marrin pjesë njëherazi në studion televizive, hapësira e studios duhet patjetër të përmbush këto kritere si dhe të ketë:

- Sipërfaqe të përpunuar akustike prej 25 m²
- Lartësi prej 2,6 m,
- Ventilim dhe aklimatizim adekuat, si dhe
- Niveli i ndriçimit në studio duhet të plotësojë minimumin që kërkohet sipas karakteristikave teknike të kamerave që përdoren në hapësirën adekuate.

Hapësira për regjinë

Neni 11

Hapësira e regjisë është hapësira në të cilën me ndihmën e pajisjeve elektronike, elektroakustike dhe pajisjeve të videos, udhëhiqet, përgatitet ose prodhohet program me përmbajtje audiovizuale dhe realizohet kontroll objektiv dhe subjektiv i sinjalit dalës të audios dhe videos, bëhet kontroll i dritës në studiot dhe kontroll i kamerave.

Sipërfaqja e hapësirës për regjinë duhet të jetë 12 m².

Çdo televizion në mënyrë të detyrueshme duhet të ketë hapësirë për regjinë.

Hapësira për montazhin

Neni 12

Hapësira për montazhin është hapësira ku bëhet montimi i emisioneve që duhet të përgatiten për emetim dhe mund të jenë pjesë e ndonjë hapësirë tjetër (p.sh, hapësira e regjisë ose hapësira e redaksisë), ku bëhet finalizimi i emisioneve nga aspekti programor dhe teknik.

Hapësirat plotësuese

Neni 13

Hapësira për arkivim është hapësira që televizioni duhet ta sigurojë për arkivimin e materialeve të incizuara audiovizuale. Hapësira për arkivim mund të jetë e vecantë ose duhet të jetë pjesë e ndonjë hapësire tjetër.

Hapësira e redaksisë është hapësirë e veçantë e punës për gazetarët.

Hapësira për vendosjen e pajisjes teknike-informatike, është hapësira ku vendosen pajisja aktive, me ventilim adekuat dhe aklimatizim si dhe pajisjet për energji të pandërprerë. Kjo hapësirë mund të jetë pjesë e ndonjë hapësire tjetër.

Hapësira për grimin me gardërobën është hapësira ku përgatiten pjesëmarrësit në program para pjesëmarrjes së tyre, dhe

Hapësirat e tualeteve.

Kushtet themelore teknike dhe hapësinore, standardet dhe parametrat për pjesën e studios së televizioneve që emetojnë program në nivel shtetëror

Kushtet hapësinore

Studio

Neni 14

Çdo televizion, i cili planifikon që në shërbimin e vet programor të shfaq program të tyre të prodhuar drejtpërdrejtë ose me prolongim (lajme, biseda me mysafir, kuize etj.) detyrimisht duhet të ketë hapësirë të përpunuar akustike të studios – studio televizive.

Varësisht nga dedikimi dhe numri i personave që planifikohen të marrin pjesë njëherazi në studion televizive, hapësira e studios duhet patjetër të përmbush këto kritere si dhe të ketë:

- Sipërfaqe të përpunuar akustike prej 25 m²
- Lartësia duhet të jetë 2,6 m, dhe
- Ventilim dhe aklimatizim adekuat.

Koha e nevojshme e reverberimit në studio

Neni 15

Koha e nevojshme e reverberimit në studion televizive varet nga volumi i hapësirës. Në shtrirje prej 200 Hz deri në 4.000 Hz ajo caktohet sipas formulës si vijon:

$$T_r = 0,25 (V/V_0)^{1/3} \text{ sec};$$

Ku:

Tr - është koha e nevojshme e reverberimit e shprehur në sekonda; V është volumi i hapsirës në metër kub (m³) dhe V₀ është volumi referent që është 100 m³.

Tejkalimi i lejuar nga koha e nevojshme e reverberimit, llogaritur sipas formulës së lartë në shtrirjen prej Hz deri 4.000 Hz është +0,05 sec.

Niveli i ndriçimit në studio

Neni 16

Niveli i ndriçimit në studio duhet të plotësojë minimumin që kërkohet sipas karakteristikave teknike të kamerave që përdoren në hapësirën adekuate.

Rekomandohet përdorimi i të ashtuquajturës dritë e ftohtë për ndriçimin e studiove.

Hapësira për regjinë

Neni 17

Hapësira e regjisë është hapësira në të cilën me ndihmën e pajisjeve elektronike, elektroakustike dhe pajisjeve të videos, udhëhiqet, përgatitet ose prodhohet program me përmbajtje audiovizuale dhe realizohet kontroll objektiv dhe subjektiv i sinjalit dalës të audios dhe videos, bëhet kontroll i dritës në studiot dhe kontroll i kamerave.

Çdo televizion në mënyrë të detyrueshme duhet të ketë hapësirë për regjinë.

Hapësira për regjinë duhet të plotësojë kriteret e theksuara në nenin 5 të kësaj rregullore, përveç në dispozitën për sipërfaqe minimale, që duhet të jetë 12 m².

Hapsira kryesore kontrolluese (Master-control room)

Neni 18

Hapësira kryesore kontrolluese (Master-control room) është hapësira ku me ndihmën e pajisjeve elektronike, elektroakustike dhe atyre për video që janë shumë të zhurmshme ose që nxehen tepër, për çka nuk mund të vendosen në hapësirën për regjinë ose në hapësirën për kontroll të prodhimit, bëhet një kontroll objektiv dhe subjektiv i sinjalit dalës të audios dhe videos në momentin kur përgatitet për emetim.

Nga hapësira kryesore kontrolluese bëhet edhe koordinimi dhe përputhja e përmbajtjeve audiovizuale prej më shumë studiove (nëse i posedon radiodifuzeri) që janë të gatshëm për emetim.

Hapësira nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të plotësojë kriteret e theksuara në nenin 5 të kësaj rregullore.

Çdo televizion që emeton program drejtpërdrejtë në nivel shtetëror, rekomandohet që të posedojë hapësirën kryesore kontrolluese.

Në rast kur televizioni nuk ka hapësirë kryesore të dedikuar, atëherë kontrolli kryesor i përmbajtjeve audiovizive kryhet në regji.

Hapësira për montazhin

Neni 19

Hapësira për montazh është hapësira ku bëhet monitorimi i emisioneve që duhet të përgatiten për emetim.

Izolimi akustik i studiove televizive dhe hapësirave kontrolluese

Neni 20

Studioja dhe hapësira për regjinë duhet të jenë të përpunuara në mënyrë akustike dhe të izoluara nga zhurma e jashtme, si dhe nga zhurma që e shkaktojnë pajisjet për ventilim dhe aklimatizim.

Niveli i lejuar i zhurmës dhe zërave të padashur në studiot televizive dhe hapësirën për regjinë në lartësi prej 1,2 metra nga dyshemeja, nuk guxon të tejkalojë vlerat e vijës HP 20 nga tabela 1.

HP linja	Frekuenca (Hz)								
	31,5	63	125	250	500	1k	2k	4k	8k
20	69,0	51,3	39,4	30,6	24,3	20,0	16,8	14,4	12,6

Tabela 1 - Niveli i lejuar i zhurmës - forca e presion të 20 μ Pa - rms për nivelit të oktavës.

Hapësirat plotësuese

Neni 21

Hapësira për arkivim është hapësira ku në kushte të veçanta ruhen dhe arkivohen materialet audiovizuale. Kjo hapësirë duhet patjetër të ndahet nga hapësirat tjera, me përjashtim të hapësirës për pajisjen teknike – informatike, që mund të jetë në përbërje të hapësirës së arkivimit.

Hapësira e redaksisë është hapësirë e veçantë e punës për gazetarët.

Hapësira për vendosjen e pajisjes teknike-informatike, është hapësira ku vendosen pajisja aktive, me ventilim adekuat dhe aklimatizim si dhe pajisjet për energji të pandërprerë. Kjo hapësirë mund të jetë pjesë e ndonjë hapësire tjetër.

Hapësira për grimin me gardërobën është hapësira ku përgatiten pjesëmarrësit në

program para pjesëmarrjes së tyre, dhe Hapësira e tualeteve.

VI. KUSHTET KADROVIKE

Numri i struktura e të punësuarve

Neni 22

Numri dhe struktura e personave të punësuar në televizionit të nivelit shtetëror që emeton program tokësor, në format të përgjithshëm duhet të jetë 80 (tetëdhjetë), prej të cilëve 30 (tridhjetë) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Numri dhe struktura e personave të punësuar për televizion të nivelit shtetëror që emeton program tokësor, në format të specializuar duhet të jetë 30 (tridhjetë), prej të cilëve 10 (dhjetë) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë. Nëse më shumë se gjysma e programeve që emetohen në shërbimin programor krijohen jashtë hapësirave të televizionit, numri i personave të punësuar mund të jetë së paku 15 (pesëmbëdhjetë), prej të cilave 5 (pesë) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetar.

Numri dhe struktura e personave të punësuar për televizion të nivelit shtetëror që emeton program përmes satelitit dhe rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara, duhet të jetë 30 (tridhjetë), prej të cilëve 10 (dhjetë) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë. Nëse më shumë se gjysma e programeve që emetohen në shërbimin programor të formatit të specializuar krijohen jashtë hapësirave të televizionit, numri i personave të punësuar mund të jetë së paku 15 (pesëmbëdhjetë), prej të cilave 5 (pesë) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetar.

Numri dhe struktura e personave të punësuar në televizion të nivelit rajonal, me përjashtim të rajonit D7 duhet të jetë së paku 10 (dhjetë), prej të cilëve 5 (pesë) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë. Nëse më shumë se gjysma e programeve që emetohen në shërbimin programor të formatit të specializuar krijohen jashtë hapësirave të televizionit, numri i personave të punësuar mund të jetë së paku 5 (pesë), prej të cilave 3 (tre) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetar.

Numri dhe struktura e personave të punësuar në televizion të rajonit D7 (që i përfshinë komunat Dibër, Mavrovë dhe Rostushë dhe Qendra Zhupë) duhet të jetë së paku 5 (pesë), prej të cilëve 3 (tre) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Numri dhe struktura e personave të punësuar në televizion në nivel lokal, duhet të jetë 5 (pesë), prej të cilëve 3 (tre) me përgatitje të lartë profesionale (PLP) të punësuar si gazetarë.

Si persona të punësuar, llogariten personat në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë të punës te radiodifuzeri dhe personat e angazhuar në bazë të kontratës në vepër dhe/ose kontratë autoriale.

VII. KUSHTET E FINANCIARE PËR TË GJITHË RADIODIFUZERËT (RADIOT DHE TELEVISIONET)

Neni 23

Radiodifuzerët janë të obliguar që të sigurojnë mjete financiare për kryerjen e pandërprerë të veprimtarisë së sigurimit të emetimit radioteleviziv për të cilën ju është dhënë leja nga ana e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, që nënkupton plotësimin e obligimeve të parapara me rregullat pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë dhe aktet nënligjore të miratuara nga ana e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore ndërpritet vlefshmëria e Rregullores për kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive nr. 01-4412/1 nga data 08.11.2013 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.154/2013).

Neni 25

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr. 01-5774/1

Shkup

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuele
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v